



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 238, datë 29.12.2021

PËR

**“MARRJEN E MASAVE PËR PARANDALIMIN E INFEKSIONIT COVID-19, PËR
PUNONJËSIT E AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, si dhe në zbatim të Urdhrit të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 561, datë 23.12.2021 “Për marrjen e masave për parandalimin e infeksionit COVID-19, për punonjësit e administratës publike, punonjësit e supermarketeve dhe qendrave tregtare”, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Çdo punonjës i Autoritetit ka detyrimin të paraqesë certifikatën e vaksinimit COVID-19 të lëshuar nga e-Albania, që vërteton vaksinimin e plotë, në formë digjitale apo të printuar pranë zyrës së Burimeve Njerëzore.**
- 2. Punonjësit të cilët nuk disponojnë certifikatë vaksinimi, duhet të paraqesin testin PCR negativ, çdo 5 ditë kalendarike, të kryer sipas procedurës për kryerjen e testeve për efekte administrative, për të vërtetuar që nuk janë mbartës të infeksionit Sars-Cov-2.**
- 3. Punonjësit të cilët kanë kaluar infeksionin Sars-Cov-2, kanë detyrim të paraqesin certifikatën e shërimit ose dokument të lëshuar nga autoritetet shëndetësore të vendit, me vlefshmëri deri në 6 muaj pas shërimit.**
- 4. Pikat 1, 2 dhe 3 do të zbatohen dhe për personat e tjerë që hyjnë në ambientet e Autoritetit.**
- 5. Përjashtim nga rregullat e përcaktuara në këtë vendim, bëhet vetëm për rastet e punonjësve që kanë indikacion mjekësor të përcaktuar me dokument mjekësor për mosaplikimin e vaksinës.**
- 6. Ngarkohet Drejtorja e Financës dhe Shërbimeve, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi më 5 janar 2022.

KRYETAR
Olsi ÇOKU

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin METE